

Departamenti Amerikan i Punës

Përfundimet rreth Formave më të Rënda të Punësimit të Fëmijëve gjatë vitit 2021

Kosovë

Në vitin 2021, Kosova ka bërë një përparim të moderuar në përpjekjet për eliminimin e formave më të rënda të punësimit të fëmijëve. Qeveria miratoi dy udhëzues administrativë për të lehtësuar zbatimin e Ligjit të ri për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe agjencitë e zbatimit të ligjit përdorën teknologjitë e reja, të zhvilluara posaçërisht për të gjurmuar rastet e punës së fëmijëve. Organet qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile morën pjesë, gjithashtu, në trajnime për drejtësinë për të miturit e mbrojtjen sociale për të rinjtë e rrezikuar, dhe qeveria vazhdoi të mbështesë një sërë programesh sociale për fëmijët në rrezik. Megjithatë, fëmijët në Kosovë vazhdojnë t'i nënshtrohen formave më të rënda të punës së fëmijëve, përfshirë edhe shfrytëzimin seksual për qëllim fitimi, në disa raste si pasojë e trafikimit të qenieve njerëzore. Fëmijët, gjithashtu, kryejnë punë të rrezikshme në rrugë, përfshirë lypjen, dhe ngarkimin e transportin e mallrave. Inspektorati i Punës dhe Qendrat e Punës Sociale hasin vështirësi në burimet financiare dhe njerëzore, gjë që mund të pengojë aftësinë e tyre për të adresuar si duhet problemet e punësimit të fëmijëve.

Sugjerime për Veprime nga Qeveria për të Eleminuar Punën e Fëmijëve		
Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
Zbatimi	Të sigurohet që Qendrat e Punës Sociale të kenë kapacitete, burime njerëzore dhe trajnime të mjaftueshme për të adresuar nevojat e posaçme të fëmijëve që janë viktime të punës.	2018 – 2021
	Të përfshihen tema mbi punën e fëmijëve, përfshirë punën e rrezikshme të fëmijëve, si në kurse trajnime ashtu edhe në rifreskimet e ofruara nga Inspektorati i Punës dhe forcat e zbatimit të ligjit; të sigurohet që trajnimet për ligjet e reja të punës së fëmijëve t'u mundësohen të gjithë inspektorëve të punës dhe personelit të zbatimit të ligjit.	2017 – 2021
	Të sigurohet që Policia e Kosovës të trajnohet për të identifikuar dhe klasifikuar si duhet rastet e lypjes së detyruar.	2020 – 2021
	Të sigurohet që autoritetet për zbatimin e ligjit për krimet të marrin trajnimin e duhur për shkelje që lidhen me punën e fëmijëve.	2021
Koordinimi	Të sigurohet që të jenë aktive komitetet e veprimit të bashkive lokale.	2012 – 2021
	Të sigurohet përmirësimi i komunikimit ndërministror midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe organeve të tjera qeveritare, për çështje që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave për punën e fëmijëve.	2021

Sugjerime për Veprime nga Qeveria për të Eleminuar Punën e Fëmijëve

Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
Politikat qeveritare	Të garantohet zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për 2020– 2024.	2020 – 2021
Programet Sociale	Të grumbullohen dhe publikohen të dhënat mbi shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve, për të informuar politikat dhe programet.	2017 – 2021
	Të eliminohen pengesat dhe arsimi të jetë i disponueshëm për të gjithë fëmijët ,duke bërë përpjekje shtesë për regjistrimin e fëmijëve me origjinën e lindjes ashkali, egjiptianë ballkanikë dhe romë, të sigurohen materiale mësimore në gjuhën amtare, dhe të subvencionohet transporti.	2011 – 2021